

Albulena Balaj Halimaj¹

UDC: 342.7-057.874:616-036.12]:373.3/.5(497.115)
342.7-057.874:616-036.12]:373.3/.5(497.7)

**TË DREJTAT THEMELORE TË NJERIUT NË ARSIMIN E
OBLIGUESHËM NË REPUBLIKËN E KOSOVËS DHE ASPEKTE
KRAHASIMORE ME REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT**

**ОСНОВНИТЕ ЧОВЕКОВИ ПРАВА ВО ЗАДОЛЖИТЕЛНОТО
ОБРАЗОВАНИЕ ВО РЕПУБЛИКА КОСОВО И СПОРЕДБЕНИ
АСПЕКТИ СО РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА**

**FUNDAMENTAL HUMAN RIGHTS IN COMPULSORY EDUCATION
IN THE REPUBLIC OF KOSOVO AND COMPARATIVE ASPECTS
WITH THE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA**

Abstract

This study examines the right to quality education of students who face persistent absences from school due to chronic illness, drawing on international human rights standards and national legal frameworks in the Republic of Kosovo and North Macedonia. The analysis focuses on the principles of equality, inclusion and non-discrimination, assessing the ways in which education systems address the needs of this category of students through legislation and institutional mechanisms that provide support for the educational process.

The methodology used is mixed-methods, including documentary analysis of legislation, interviews with teachers, parents and education experts, and case studies in several educational institutions. The results show that there is an obvious lack of clear policies and pedagogical support for students with chronic illnesses, which leads to deepening educational inequalities and the silent exclusion of these students.

The study provides an analytical framework that helps understand the connection between human rights and equal access to education. Its

¹ Autorja është studente në ciklin e tretë në Fakultetin Juridik në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë, Drejtimi: E Drejta Kushtetuese dhe Administrative.
Email: albulenabalaj@yahoo.com

recommendations include developing inclusive policies that ensure quality education for all and improving teacher training to meet the challenges of diverse classrooms.

This study also argues that multifaceted support is essential to create a supportive environment where every student, regardless of health challenges, has the opportunity to achieve their educational potential. This requires partnerships between institutions, parents and health professionals.

Keywords: *human rights, quality education, inclusion, chronic disease, long-term absences, educational policy, pedagogical support.*

Hyrje

Idetë e para për të drejtat e njeriut janë të hershme, që nga paraqitja e formacioneve të para të organizuara të shoqërisë njerëzore. Pikënisja e konceptit të të drejtave të njeriut është koncepti i dinjitetit të lindur dhe të patjetërsueshëm të të gjithë njerëzve. Të drejtat e njeriut janë të drejta të cilat burojnë nga të qenit qenie njerëzore, si të tilla ato nuk janë dhuruar dhe shkruar nga asnjë shtet. Në pjesën hyrëse të Deklaratës së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (1948) shkruhet: ***“të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta. Ata kanë arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të sillen ndaj njëri tjetrit me frymë vëllazërimi.”***². Këto të drejta universale janë të qenësishme për të gjithë ne, pavarësisht nga kombësia, gjinia, origjina kombëtare ose etnike, ngjyra, feja, gjuha ose ndonjë status tjetër. Ato variojnë nga më themeloret - e drejta për jetë - deri tek ato që e bëjnë jetën të vlefshme, siç janë të drejtat për ushqim, arsim, punë, shëndet dhe liri. “E drejta për arsim mund të cilësohet si e drejtë e fuqizimit”³. Një e drejtë e tillë i lejon individit të ketë më shumë kontroll mbi rrjedhën e jetës, sidomos kontrollin mbi veprimet e shtetit që kanë të bëjnë me individin. “Arsimi mund të nxisë respektin, tolerancën, mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndërmjet individëve, grupeve etnike apo religjioze dhe mund të kontribuojë në krijimin dhe forcimin e një kulture universal të të drejtave të njeriut”⁴. Në këtë kontekst arsimimi cilësor për çdo fëmijë përbën jo vetëm një të drejtë ligjore por edhe një domosdoshmëri sociale dhe morale. *Megjithëse ligjet arsimore në vendet me sisteme demokratike garantojnë të drejtën për arsimim për të gjithë, nxënësit me sëmundje kronike shpesh përjashtohen në mënyrë të heshtur nga përfshirja e plotë në procesin mësimor. Studimi ka arritur në përfundimin se fëmijët/nxënësit me sëmundje kronike në Republikën e Kosovës përballen me vështirësi në realizimin e të drejtës së tyre themelore*

² Deklarata e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut, 1948, neni 1.

³ Wolfgang Benedek (editor), Kuptimi i të drejtave të njeriut (manual), f. 269, Graz, 2009

⁴ Po aty.

për arsim gjithëpërfshirës dhe cilësor, jo në pak raste janë të përjashtuar në heshtje nga procesi edukativo-arsimor i obligueshëm, për arsye të legjislacionit arsimor sekondar të papërshtatshëm. Andaj një përmirësim (plotësim/ndërhyrje) në këtë drejtim është i domosdoshëm.

Qëllimi dhe objektivat

Arsimi ka të bëjë më shumë se të mësuarit e leximit, shkrimit dhe llogaritjes. Vetë fjala latine educare e ka kuptimin “edukoj”, “rris”. Arsimimi i ndihmon njerëzit të kenë qasje në të gjitha të drejtat e tjera njerëzore. Arsimi përmirëson shanset e një individi në jetë dhe ndihmon në trajtimin e varfërisë, ulë pabarazitë sociale, ndihmon çdo individ të arrijë potencialin e tij të plotë.

Qëllimi i këtij studimi është analiza, vlerësimi, dokumentimi dhe krahasimi i të drejtës së arsimit të obligueshëm në Republikën e Kosovës dhe aspekte krahasimore me Republikën e Maqedonisë së Veriut, me qëllim të gjetjes së përparësive dhe vështirësive eventuale ligjore dhe të tjera në përmbushjen e kësaj të drejte themelore të njeriut nga institucionet dhe autoritetet e Republikës së Kosovës, konkretisht nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoritë Komunale të Arsimit, shkollat si institucione edukative-arsimore dhe të prindërve si bashkëpërgjegjës në edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të tyre.

Objektivat e studimit janë: 1. analiza e politikave aktuale arsimor në Republikën e Kosovës dhe të Maqedonisë së Veriut në raport me të drejtën për arsim cilësor për nxënësit me mungesa afatgjata për shkak të sëmundjeve kronike. 2. Identifikimi i përparësive dhe nevojës për përmirësim në legjislacionin aktual në Republikën e Kosovës dhe përligjja e tyre përmes legjislacionit sekondar.

Hipoteza

Republika e Kosovës arsimin e obligueshëm e ka përligjur në Kushtetutë dhe në ligje, sipas dokumenteve dhe standardeve ndërkombëtare, megjithatë legjislacioni sekondar ka nevojë për ndryshime dhe plotësime, përmes të cilave duhet sigurohet arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës, në veçanti për nxënësit me probleme shëndetësore dhe sëmundje kronike.

Rëndësia e studimit

Duke qenë se arsimi i obligueshëm nëntëvjeçar është përligjur përmes Kushtetutës së Republikë së Kosovës (2008) dhe ligjeve përkatëse, konkretisht nr. 04/L-032/2012 - ligji për arsimin parauniversitar në Kosovës dhe nr.03/L-068 / 2008 - për Arsimin në Komunitet e Kosovës, është obligimi i autoriteteve përgjegjëse të ndërtojnë dhe zbatojnë dispozita ligjore, politika dhe dokumente të tjera, përmes të cilave ofrohet dhe mbështetet arsimi i obligueshëm dhe cilësor për të gjithë fëmijët/nxënësit pa dallime gjinie, përkatësie

komunitare dhe të perspektivave intelektuale, fizike, emocionale dhe shëndetësore. Legjislacioni aktual primar dhe sekondar komunitetin e nxënësve me perspektivë shëndetësore nuk e trajton në mënyrë të duhur përkatësisht nuk ju siguron arsim cilësor, duke ju shkelur një të drejtë themelore. Ky studim synon që pas hulumtimeve të bëra në terren, analizës së politikave aktuale arsimore, krahasimit të tyre me politikat, modelet dhe përvojat e mira të vendeve të tjera, në rastin konkret të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të nxjerr përfundime dhe rekomandime për autoritetet e Republikës së Kosovës për përmirësimin e shërbimeve cilësore arsimore për komunitetin e nxënësve me perspektiva shëndetësore.

Metodologjia e hulumtimit

Që hulumtimi të jetë sa më shkencor, dokumentues dhe udhëzues janë përdorur një numër i caktuar i metodave të përgjithshme dhe specifike hulumtuese, konkretisht: metoda historike-logjike, metoda induktive dhe deduktive, metoda e analizës dhe sintezës, metoda e analizës së dokumentacionit, metoda krahasimore.

Një vështrim i shkurtër i të drejtave të njeriut në arsim

Në vitin 539 p.e.s., ushtritë e Kirit të Madh, mbretit të parë të Persisë së lashtë, pushtuan qytetin e Babilonisë. Por ishin veprimet e tij të radhës që shënuan një përparim të madh për Njeriun. Ai liroi skllevërit, deklaroi se të gjithë njerëzit kishin të drejtë të zgjidhnin fenë e tyre dhe vendosi barazi racore. Këto dhe dekrete të tjera u regjistruan në një cilindër prej balte të pjekur në gjuhën akade me shkrim kuneiform”⁵.

Dokumentet që pohojnë të drejtat individuale, të tilla si Magna Carta (1215), Peticioni i së Drejtës (1628), Kushtetuta e SHBA (1787), Deklarata Franceze e të Drejtave të Njeriut dhe Qytetarit (1789) dhe Projektligji i SHBA-së Të drejtat (1791) janë pararendësit e shkruar të shumë prej dokumenteve të sotme të të drejtave të njeriut”⁶.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (UDHR), e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në vitin 1948, ishte dokumenti i parë ligjor që përcaktonte të drejtat themelore të njeriut për t'u mbrojtur në mënyrë universale. “Secili gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë Deklaratë pa kurrfarë kufizimesh për sa i përket racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës,

⁵ <https://www.humanrights.com/course/lesson/background-of-human-rights/the-background-of-human-rights.html>

⁶ <https://www.humanrights.com/course/lesson/background-of-human-rights/the-background-of-human-rights.html>

besimit fetar, mendimit politik ose tjetër, originës kombëtare a shoqërore, pasurisë, lindjes ose tjetër...”⁷

Një e drejtë themelore e njeriut e garantuar përmes Deklaratës së Përgjithshme të të Drejtave të Njeriut (1948) është e drejta në arsimim përkatësisht shkollim e cila garantohet me nenin 26 të saj (e drejta e shkollimit). “Gjithkush ka të drejtën e shkollimit. Arsimi duhet të jetë falas, të paktën në shkollat fillore dhe të ulëta. Arsimi fillor është i detyrueshëm. Arsimi teknik dhe profesional duhet të zgjerohet e arsimi i lartë duhet t’u bëhet i mundshëm të gjithëve në bazë të aftësisë”⁸

“Arsimi duhet të drejtohet nga zhvillimi i plotë i personalitetit të njeriut dhe nga forcimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Ai duhet të nxisë kuptimin, tolerancën dhe miqësinë midis të gjithë popujve, grupeve të racave dhe besimeve, si dhe veprimtarinë e Kombeve të Bashkuara për ruajtjen e paqes”⁹. “Të drejtën për të zgjedhur llojin e arsimit për fëmijët e tyre e kanë në radhë të parë prindërit”¹⁰.

Përveç Deklaratës së Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut të vitit 1948, arsimi përfshihet edhe në shumë dokumente të tjera ndërkombëtare:

- Konventa e UNESCO kundër diskriminimit në arsim (1960)
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (1966)
- Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave (1979)
- Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe të Popullit (1986)
- Konventa për të Drejtat e Fëmijës (1989)
- Deklarata Botërore për Arsimin për të Gjithë: Përmbushja e Nevojave Bazë të Mësimi (1990)
- Kuadri Dakar për Veprim: Arsim për të Gjithë (2000)
- Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2006)
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së për të Drejtën për Arsim në Situata Emergjente (2010)

Vështrim i shkurtër historik i zhvillimit të drejtave të njeriut në arsimim të detyrueshëm

Arsimi, në veçanti shkathtësitë e leximit dhe të shkrimit janë të hershme dhe të vlerësuara qysh në lashtësi (nga shoqëria skllavopronare sidomos tek egjiptasët e vjetër, sumerët, indianët, kinezet persianët, grekët, ilirët etj.).

⁷ Po aty, neni 2.

⁸ Deklarata e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut, 1948, neni 26, pika 1.

⁹ Po aty, neni 26, pika 2.

¹⁰ Po aty, neni 26, pika 3

Idetë e para në arsimin e detyrueshëm lidhen me Republikën (Shtetin) e Aristokles (Platonit). “Në këtë vepër Platoni projektoi edhe sistemin e parë edukativo-arsimor, me të gjitha hallkat e tij”¹¹. Projekti i Platonit parashikonte që fëmijët pas moshës 7 vjeçare të vendosen në institute (shkolla) shtetërore, të cilat duhet të ishin të veçanta për djem dhe të veçanta për vajza.

Popullarizimi i ideve të Platonit filloi në periudhën e Humanizmit dhe të Renesancës (Vitorino da Feltre, Tomazo Kampanela etj), në veçanti me përkthimin e veprave të Platonit nga Marsilio Ficino (1434-1499), duke kulmuar me idetë pedagogjike dhe iluminizmin francezë (Deni Didro, Zhan Zhak Ruso - Jean-Jacques Rousseau etj.) i njohur për veprën e tij për edukimin dhe arsimin, të botuar në Paris 1762, “Emile, ou De l’éducation”- Emile, ose për edukimin).

Aleanca Trefishe Aztec, e cila sundoi nga 1428 deri në 1521 në atë që tani është Meksika Qendrore, konsiderohet të jetë shteti i parë që zbatoi një sistem të arsimit të detyrueshëm universal”¹².

Teksti themelor i Martin Luterit *An die Ratsherren aller Städte deutschen Landes* (Për këshilltarët e të gjitha qyteteve në vendet gjermane, 1524) bëri thirrje për vendosjen e shkollimit të detyrueshëm në mënyrë që të gjithë famullitë të mund të lexonin Biblën vetë. Në vitin 1559, Dukati gjerman Württemberg krijoi një sistem arsimor të detyrueshëm për djemtë. Në 1592, Dukati Gjerman Palatine Zweibrücken u bë territori i parë në botë me arsim të detyrueshëm për vajzat dhe djemtë e ndjekur në 1598 nga Strasburgu, atëherë një qytet i lirë i Perandorisë së Shenjtë Romake dhe tani pjesë e Francës”¹³.

Në Skoci, Akti i Themelimit të Shkollës 1616 urdhëroi çdo famulli të krijonte një shkollë për të gjithë të paguar nga famullitë. Parlamenti i Skocisë e konfirmoi këtë me Aktin e Arsimit 1633 dhe krijoi një taksë lokale me bazë tokën për të siguruar fondet e kërkuara”¹⁴.

Ligjet e Shkollës së Massachusetts, tre akte legjislative të miratuara në Koloninë e Gjirit të Massachusetts në 1642, 1647 dhe 1648, konsiderohen zakonisht si hapat e parë drejt arsimit të detyrueshëm në Shtetet e Bashkuara. Ligji i vitit 1647, në veçanti, kërkonte që çdo qytet që kishte më shumë se 50 familje të punësonte një mësues dhe çdo qytet me më shumë se 100 familje të krijonte një shkollë”¹⁵.

Prusia zbatoi një sistem arsimor të detyrueshëm modern në 1763. Ai u prezantua nga *Generallandschulreglement* (Rregullorja e Përgjithshme e Shkollës), një dekret i Frederikut të Madh në 1763”¹⁶.

Ndjekja e detyrueshme e shkollës sipas modelit prusian u përhap gradualisht në vende të tjera. Ai u miratua shpejt nga qeveritë në Danimarkë-

¹¹ Po aty, f. 83

¹² https://en.wikipedia.org/wiki/Compulsory_education (parë për herë të fundit më 11.06.2024)

¹³ Po aty.

¹⁴ Po aty.

¹⁵ Po aty.

¹⁶ Po aty.

Norvegji dhe Suedi (1739), Finlandë, Estoni dhe Letoni brenda Perandorisë Ruse, dhe më vonë Angli dhe Uells dhe Francë, Austri 1774, Greqi 1838, Portugali 1844, Spanjë 1857, Mali i Zi 1868, Itali 1869, Bullgari 1878, Angli 1880, Francë 1882, Serbi 1882, Holandë 1900, Shqipëri 1912, Belgjik 1919, Estoni 1920, Finlandë 1921 etj.

Arsimi i obligueshëm në Kosovë

Kosova në nëntor 1912 pushtohet nga shteti serb i kohës. Ky pushim zgjat deri në vitin 1999. Në 1929, Serbia borgjeze (ish mbretëria SKS) nxjerr Ligjin për shkollat popullore, por nga ky ligj nuk përfituan fëmijët/nxënësit shqiptarë, sepse mësimi zhvillohej në gjuhën serbe. Në vitin 1945 Ligji për shkollimin e detyrueshëm 7 vjeçar (tetor 1945) mësimi në gjuhën shqipe bëhet i detyrueshëm në nivelin fillor (klasat I-IV) për djem dhe vajza. Në vitin shkollor 1944/1945 në Kosovë ishin hapur dhe punonin 278 shkolla fillore katërklasëshe, nga të cilat 135 në gjuhën mësimore shqipe. Viteve në vijim, e gjerë në vitin 1990 shqiptarët e Kosovës njohën një zhvillim të konsiderueshëm në sferën e arsimit, u hap shumë shkolla të tjera fillore, të mesme dhe të larta/fakultete, deri tek Universiteti i Kosovës. Vitet 1990-1999 janë vite të aparteidit, kulturocidit dhe dhunës së padëgjuar ndonjëherë ndaj arsimit shqip. Serbia serbizoi sistemin edukativ-arsimor në gjuhën shqipe, mbylli gjitha shkollat dhe fakultetet në gjuhën shqipe dhe demoloi, shkatërroi, dogji, qindra objekte shkollore, helmoi nxënësit shqiptar, dëboi nga puna, rrahu, burgosi dhe vrau nxënës dhe mësimdhënës shqiptar. Në vitet 1990-1999 shqiptarët organizuan mësimin paralele në gjuhën shqipe, në të gjitha nivelet. Në vitin 2000 filloi rimëkëmbja e sistemit arsimor parauniversitar dhe atij universitar në Republikën e Kosovës.

Disa tregues për arsimin e obligueshëm

Përkundër ndryshimeve pozitiviste si në qasje dhe në politika arsimore dhe financiare, në botë ende ka probleme të mëdha rreth arsimit të obligueshëm. Treguesit e shumtë e dokumentojnë se rreth 258 milionë fëmijë dhe të rinj janë jashtë shkollës, sipas të dhënave të UIS për vitin shkollor që përfundon në 2018. Në total përfshihen 59 milionë fëmijë të moshës së shkollës fillore, 62 milionë të moshës së shkollës së mesme të ulët dhe 138 milionë të moshës së mesme të lartë. 155 vende garantojnë ligjërisht 9 vjet ose më shumë arsim të detyrueshëm Vetëm 99 vende garantojnë ligjërisht të paktën 12 vjet arsim falas 8,2% e fëmijëve të moshës së shkollës fillore nuk shkojnë në shkollën fillore Vetëm gjashtë në dhjetë të rinj do të mbarojnë shkollën e mesme në vitin 2030 Shkalla e arsimimit të të rinjve (15-24) është 91,73%, që do të thotë se 102 milionë të rinj nuk kanë aftësitë bazë të shkrim-leximit.”

Në Republikën e Kosovës gjithashtu ka probleme për sa i përket shkollimit të obligueshëm, treguesit e MASHT e vërtetojnë se rreth 9.10% e fëmijëve të cilët regjistrohen në klasën e pare të shkollimit të obligueshëm fillor, nuk janë pjesëmarrës në arsimin e mesëm të ulët (kl.VI-IX) përkatësisht nuk arrin të përfundojnë klasën IX.

Baza ligjore aktuale e arsimit të obligueshëm (themelor) në Republikën e Kosovës

Edukimi përkatësisht arsimit i detyrueshëm në Kosovë që nga viti 1974 ishte i ligjësuar, përveç me dispozita ligjore (Ligji për arsimin fillor në Kosovë nr.26/78) edhe me dispozita kushtetuese. Kapitulli III i Kushtetutës, neni 170 liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të qytetarëve përkatësisht neni 182 e drejta dhe detyrimi për arsim të obligueshëm. Përmes kësaj dispozite kushtetuese (neni 182) përcaktohej që mësimi i obligueshëm i cili duhet të zgjatë minimalisht 8 vite shkollimi është pa pagesë dhe rregullohej me ligj. Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës (2008) arsimit themelor është i obligueshëm dhe garantohet për të gjithë, rregullohet me ligj dhe financohet nga fondet publike (neni 47). “Secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë. Shkollimi i detyrueshëm rregullohet me ligj dhe financohet nga fondet publike”¹⁷. “Institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t’u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj”¹⁸.

Institucioni më i lartë shtetëror përgjegjës për arsimin dhe shkencën në Republikën e Kosovës është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Në kuadër të kësaj ministrie funksionon një departamenti i veçantë i cili merret me planifikimin, zhvillimin dhe organizimin e arsimit në nivelin parauniversitar, rrjedhimisht edhe në nivelin e arsimit të obligueshëm (fillor dhe të mesëm të ulët). Është në autoritetin e MASHT dhe të Kuvendit që të nxjerrë ligje dhe akte nënligjore (udhëzime administrative, rregullore, urdhëresa, rekomandimet, dokumente të tjera) për funksionimin e të gjitha mekanizmave të cilat e përbëjnë sistemin parauniversitar përfshirë dhe të drejtat dhe liritë e fëmijëve, hartimin e kurrikulave, sigurimin e teksteve dhe mjeteve mësimore, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e objekteve shkollore, ofrimin e kushteve dhe mundësive për zhvillimin e potencialeve të secilit fëmijë/nxënës etj. Bazuar në dispozitat kushtetuese, konkretisht në nenin 47 pika 1 të Kushtetutës (2008) dhe në Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës (2007) në Republikën e Kosovës përveç Ligjit të arsimit parauniversitar nr. 04/L-032 (2012) ka edhe një ligj të veçantë (specifik), përmes të cilit komunave ju sigurohet autoriteti të zgjeruar në fushën e arsimit, konkretisht Ligji për Arsimin në Komunitet e Kosovës nr. 03/L-068 (2008).

¹⁷ Kushtetuta e Kosovës 2008, neni 47, pika 1.

¹⁸ Po aty, neni 47, pika 2.

Bazuar në dispozitat e këtij ligji, njësitë vendore përkatësisht komunat gëzojnë të drejta dhe përgjegjësi të konsiderueshme në nivelin e arsimit parauniversitar, ndërsa një komunën e veçantë, ajo e Mitrovicës së Veriut edhe në planifikimin dhe organizimin e arsimit në nivel universitar.

- Qëllimi i këtij ligji është të rregullojë organizimin e institucioneve arsimore publike dhe ofrimin e arsimit publik në nivelet arsimore parashkollore, fillore, të mesëm të ulët, të mesëm të lartë dhe të lartë në komunat e Republikës së Kosovës. Asnjë dispozitë e këtij ligji nuk mund të interpretohet si pakësim apo kufizim i të drejtave të cilat komunitetet dhe anëtarët e tyre i gëzojnë sipas ligjit në fuqi¹⁹.

Ligji nr.03/L-068 (2008) ka dispozita ligjore të veçanta (Kreu V i ligjit, neni 12) të cilat ekskluzivisht përligjin arsimin në gjuhën serbe në nivelin parauniversitar, përkatësisht përcaktojnë kompetencat e komunave për krijimin e kushteve për ofrimin e shërbimeve edukative-arsimore në mësimin në gjuhën serbe, përfshirë edhe planet dhe programet mësimore dhe tekstet shkollore, të cilat mund të jenë të ndryshme nga ato në mësim në gjuhën shqipe, për më shumë të hartuara dhe miratuara nga Ministria e Arsimit e një shtetit tjetër, në rastin konkret të Republikës së Serbisë.

“Komunat kanë kompetenca për krijimin e kushteve për ofrimin e shërbimeve edukativo-arsimore në gjuhën serbe”²⁰. “Shkollat të cilat japin mësim në gjuhën serbe mund të përdorin plan programe apo tekste shkollore të hartuara nga Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë pas njoftimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës”²¹. Plan programet apo tekstet shkollore përkatëse të Republikës së Serbisë nuk do të përdoren për mësimdhënie para njoftimit të MASHT-it; nëse pas këtij njoftimi, MASHT-i brenda tre muajve nuk paraqet ndonjë kundërshtim (në mënyrë që t’i ofrohet kohë e mjaftueshme Ministrisë të shqyrtojë planet dhe programet apo tekstet shkollore në fjalë), ai material mund të përdoret”²². Në rast të paraqitjes së kundërshtimit nga ana e MASHT-it për përdorimin e ndonjë plan program apo teksti shkollor të caktuar në gjuhën serbe, çështja i dërgohet komisionit të pavarur, i cili themelohet në bazë të nenit 13 të këtij ligji, për të shqyrtuar plan programin apo librin shkollor në fjalë, për të siguruar përputhshmërinë e tij me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin në fuqi. Plan program mësimor i caktuar ose teksti shkollor nuk mund të përdoren për mësimdhënie pa vendosur komisioni i pavarur”²³.

¹⁹ Ligji për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës nr. 03/L-068

²⁰ Po aty, neni 12, pika 1

²¹ Po aty, neni 12, pika 2.

²² Po aty, neni 12 pika 3.

²³ Po aty, neni 12 pika 4.

Parimet e Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Kosovë (nr.04/L-032 / 2012)

Ministria, komunat, si dhe institucionet arsimore dhe ato aftësuese do të marrin parasysh normat e miratuara ndërkombëtare për arsimin për të gjithë, të drejtat e fëmijëve, mbrojtjen e grupeve të ndjeshme në shoqëri dhe për avancimin e barazisë gjinore²⁴.

Gjatë zbatimit të funksioneve dhe përgjegjësi të tyre në kuadër të këtij ligji dhe ligjeve të tjera në fuqi, Ministria, komunat dhe institucionet arsimore apo ato aftësuese do të: respektojnë dhe avancojnë të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, siç parashihet me Kushtetutë dhe me ligjet në fuqi; kultivojnë njohuritë për kulturën, historinë, dhe gjuhën e të gjitha komuniteteve²⁵.

Qasja dhe përparimi nëpër të gjitha nivelet e arsimit dhe aftësimit parauniversitar do të mundësohet në pajtim me dispozitat e këtij ligji pa diskriminim në baza ekzistuese ose të supozuara, siç është ai: gjinor, racor, i orientimit seksual, i paaftësitë fizike, intelektuale ose i çfarëdo paaftësie tjetër, i gjendjes martesore, i ngjyrës, i fesë, i opinioneve politike apo të tjera, i përkatësisë kombëtare, etnike ose shoqërore, i shoqërimit me ndonjë komunitet, i pronës, i lindjes ose i ndonjë gjendje tjetër të nxënësit apo familjes së tij²⁶.

Organizimi i arsimit parauniversitar në Kosovë

Niveli 0: Arsimi parashkollor (normalisht mosha zero (0) deri në gjashtë (6) vjeç, faza kyçe 0 dhe një pjesë e fazës 1 e KKK), i rregulluar me këtë ligj vetëm për moshën pesë (5) deri gjashtë (6) vjeçare (shkollë para-fillore); niveli 1: Arsimi fillor që zgjat 5 vite (normalisht prej moshës gjashtë (6) vjeçare, pjesa e mbetur e fazës 1 dhe 2 e KKK); niveli 2: Arsimi i mesëm i ulët që zgjat katër (4) vite (normalisht prej moshës dymbëdhjetë (12) vjeçare, faza 3 dhe 4 e KKK)²⁷.

Shkollimi i detyruar fillon në fillim të vitit shkollor pas datës kur fëmija arrin moshën gjashtë (6) vjeçare që është mosha minimale për shkollimin e detyruar dhe përfundon në fund të nivelit 2 të ISCED-it²⁸. Shkollimi i detyruar ofrohet falas²⁹.

Caktimi i nxënësve nëpër institucionet arsimore: secila shkollë e nivelit 1 dhe 2 të ISCED-it ka zonën e saj të mbulimit, të përcaktuar nga komuna³⁰.

²⁴ Po aty, neni 5, pika 1,2,3,4.

²⁵ Po aty, neni 5, pika 5,6.

²⁶ Po aty, neni 5, pika 7.

²⁷ Po aty, neni 9.

²⁸ Po aty.

²⁹ Po aty.

³⁰ Po aty, neni 14, pika 1.

Për nxënësit me vështirësi në të nxënë apo me aftësi të kufizuara, sipas nenit 39 të këtij ligji, komuna ka për obligim që t'i regjistrojë ata nxënës dhe më pas të veprojë sipas procedurave të parapara në nenin 41 të këtij ligji³¹.

Për nxënësit që flasin gjuhë jo-zyrtare dhe që jetojnë në një zonë të mbulimit ku nuk arrihet minimumi për hapjen e klasave apo të shkollave të niveleve 1 dhe 2 të ISCED-së për mësim në ndonjë gjuhë që nuk është gjuhë zyrtare, komuna ofron alternativë, si parashihet në nenin 13, paragrafin 3. të këtij ligji³².

Vijueshmëria në shkollë

Vijimi i shkollimit të detyruar nga ana e nxënësit është një përgjegjësi kryesore e prindit. Prindi i fëmijës së moshës së shkollimit të detyruar bën shkelje të ligjit, nëse: nuk e regjistron fëmijën në shkollë publike, institucion aftësimi, shkollë speciale ose shkollë private të licencuar dhe të përshtatshme për moshën e fëmijës dhe për nivelin e mësimi, ose nuk bën aranzhime alternative për arsimimin e fëmijës me miratim nga Ministria sipas nenit 47 të këtij ligji, ose pa shkak të arsyeshëm, si është sëmundja apo ndonjë shkak tjetër i pashmangshëm, nuk i siguron fëmijës vijim të rregullt në institucionin arsimor në kohën e përcaktuar nga këshilli drejtues për fillimin e mësimi³³. Kur drejtori i institucionit arsimor dhe aftësues e sheh të arsyeshme dhe në interesin më të mirë të nxënësit, pas marrjes së kërkesës me shkrim nga prindërit e nxënësit, mund ta lirojë nxënësin nga vijimi i mësimi deri në (2) dy javë gjatë vitit shkollor³⁴. Nëse nxënësi pa ndonjë arsye nuk regjistrohet, nuk vijon shkollimin ose e ndërprente shkollimin e detyruar, prindërit e tij dënohen për kundërvajtje nëse mungesa është rezultat i veprimit të paramenduar ose i neglizhencës së prindërve. Në raste të tilla, komuna e njofton Ministrinë me shkrim³⁵.

Shkollimi në shtëpi

1. Nëse komuna vlerëson se ndonjë fëmijë i moshës së shkollimit të detyruar nga territori i saj nuk është duke u arsimuar në mënyrë të duhur, përmes vijueshmërisë së rregullt në shkollë ose ndryshe dhe nuk i nënshtrohet përjashtimit të përhershëm sipas këtij ligji, ajo i dërgon një vërejtje me shkrim prindërve dhe kërkon nga ata që të bindin komunën brenda afatit kohor të përcaktuar në vërejtje se fëmija është duke u arsimuar në shtëpi ose diku tjetër.

³¹ Po aty, neni 14, pika 3.

³² Po aty, neni 14, pika 4.

³³ Ligji për Arsimin Parauniversitar në Kosovë nr.04/L-032 (2012) neni.

³⁴ Po aty, neni.

³⁵ Po aty, neni.

2. Arsimim i duhur sipas paragrafit 1. të këtij neni do të thotë arsimim efikas me orar të plotë që është i përshtatshëm për moshën, aftësitë dhe prirjen e fëmijës si dhe ndonjë nevojë të veçantë për arsim që fëmija mund të ketë.

3. Nëse prindërit nuk i përgjigjen komunës brenda afatit kohor të specifikuar në vërejtjen e cekur në paragrafin 1. të këtij neni, komuna e procedon rastin në procedurë për kundërvajtje.

4. Nëse prindërit përgjigjen se fëmija është duke u arsimuar jashtë sistemit formal të arsimit dhe aftësimit publik ose privat, aranzhimet e bëra nga prindërit si dhe ato të inspektoratit duhet t'i nënshtrohen autorizimit të Ministrisë pas konsultimeve me komunën përkatëse³⁶

Aspekte krahasimore me Republikën e Maqedonisë së Veriut

“Secili ka të drejtë në arsimim”³⁷.

“Arsimimi është i arritshëm për secilin në kushte të barabarta. Arsimimi fillor është i detyrueshëm dhe pa pagesë”³⁸.

Përmes Ligjit për arsimin fillor, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përcaktohen dhe përligjen aspekte të përgjithshme dhe specifike të cilat kanë të bëjnë me arsimin fillor, duke përfshirë qëllimin, parimet, strukturën/nivelet, autoritetet, mbikëqyrjen, inspektimin, kurrikulën, zhvillimin profesional, licencimin e mësimitdhënësve, etj.

Me këtë ligj rregullohet procesi edukativo-arsimor i cili realizohet në shkolla fillore, si dhe veprimtaria e arsimit fillor si pjesë e sistemit unik edukativo-arsimor³⁹.

Veprimtaria e arsimit fillor është me interes të veçantë publik”⁴⁰

Me këtë ligj rregullohet procesi edukativo-arsimor i cili realizohet në shkolla fillore, si dhe veprimtaria e arsimit fillor si pjesë e sistemit unik edukativo-arsimor. Veprimtaria e arsimit fillor është me interes të veçantë publik”⁴¹.

E drejta e arsimit fillor

Çdo fëmijë ka të drejtë të edukimit dhe arsimimit fillor falas dhe cilësor në shkollë fillore”⁴².

Në arsimin fillor mund të përfshihen edhe persona të moshuar, në pajtim me Ligjin për arsimin e të moshuarve”⁴³.

³⁶ Po aty, neni 47.

³⁷ Kushtetuta e Maqedonisë së Veriut, neni 44.

³⁸ Po aty.

³⁹ Ligji për Arsimin Fillor në Republikën e Maqedonisë së Veriut, nr.161/2019 dhe 229/2020.

⁴⁰ Po aty.

⁴¹ Po aty.

⁴² Po aty, neni 3 pika 1.

⁴³ Po aty, neni 3 pika 2.

Me propozim të Byrosë për Zhvillimin e Arsimit (në tekstin e mëtejshëm: Byroja) dhe të Komisionit Shtetëror të Provimeve, ministri i Arsimit dhe Shkencës (në tekstin e mëtejshëm: ministri) miraton standarde për përcaktimin e cilësisë në arsimin fillor⁴⁴

Parimet e arsimit fillor

Arsimi fillor zhvillohet në bazë të parimeve si vijojnë:

- interesi më i mirë dhe zhvillimi i plotë i nxënësit,
- barazia, arritshmëria, qasja dhe inkluziviteti,
- karakteri i përgjithshëm arsimor i arsimit fillor,
- sigurimi i cilësisë së arsimit dhe krahasimi ndërkombëtar i njohurive të nxënësve,
- pjesëmarrja aktive e nxënësve në jetën e shkollës dhe komunitetit,
- përgatitja e nxënësit për mësim gjatë gjithë jetës,
- avancimi i ngjashmërive dhe pranimi i dallimeve, interkulturës, multikulturalizmit, interkulturalizmit, interkulturalizmit,
- kujdesi për sigurinë dhe shëndetin fizik,
- autonomia, kompetenca dhe përgjegjësia dhe
- partneriteti ndërmjet shkollës, prindërve, përkatësisht kujdestarëve dhe njësive të vetëqeverisjes lokale⁴⁵.

Vendi i organizimit dhe realizimit të arsimit fillor

(1) Arsimi fillor organizohet dhe realizohet në shkollë fillore.

(2) Arsimi fillor organizohet dhe realizohet edhe në institucione shëndetësore, institucione ndëshkimore-përmirësuese dhe edukative-përmirësuese, si dhe në kushte shtëpiake, në pajtim me këtë ligj.

(3) Shkolla organizon proces edukativo-arsimor në kushte shtëpiake si formë e veçantë e punës për nxënës në mjekim më të gjatë shtëpiak.

(4) Për nxënësit të cilët, për shkak të problemeve shëndetësore ose sëmundjeve kronike, nuk mund të ndjekin mësim më gjatë se tri javë, mësimi organizohet në kushte shtëpiake, përkatësisht në institucion shëndetësor.

(5) Prindi, përkatësisht kujdestari e njofton shkollën për nevojën e mësimi të nxënësit i cili është në mjekim më të gjatë shtëpiak ose spitalor.

(6) Arsimin fillor në institucione shëndetësore dhe ndëshkimore-përmirësuese dhe edukative-përmirësuese, e realizon shkolla e cila është më afër institucionit dhe realizon mësim në gjuhën amtare të nxënësit në këto institucione, ndërsa në kushte shtëpiake shkolla ku është regjistruar nxënësi.

⁴⁴ Po aty, neni 3 pika 3.

⁴⁵ Po aty, neni 14.

(7) Mënyrën e zgjedhjes së shkollës fillore, kriteret më të afërta dhe mënyrën e organizimit të mësimit në institucionet nga paragrafi (2) i këtij neni, si dhe në kushte shtëpiake i përcakton ministri, me propozim të Byrosë⁴⁶.

Nëse bëjmë një krahasim në mes të dispozitave ligjore pozitive në Republikën e Kosovës me ato të Republikës së Maqedonisë, për sa i përket të drejtave në arsim, arrijmë në përfundimet:

- Në Republikën e Kosovës dhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut e drejta në arsim është e drejtë kushtetuese e përligjur me nenin 47 të Kushtetutës së Kosovës (2008) përkatësisht XX të Kushtetutës së Maqedonisë së Veriut. Secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë. Shkollimi i detyrueshëm rregullohet me ligj dhe financohet nga fondet publike;

- Në Republikën e Kosovës ekzistojnë dhe janë në fuqi dy ligje specifike të cilat rregullojnë çështjet e përgjithshme dhe specifike të arsimit, duke përfshirë edhe arsimin e detyrueshëm, konkretisht ligji nr. 04/L-032 për arsimin parauniversitar (2012) dhe Ligji nr.03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Kosovës (2008 - produkt i Marrëveshjes Gjithpërfshirëse për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës);

- Bazuar në ligjet ekzistuese, autoritetet vendore, komunat, kanë më shumë autoritet në fushën e arsimit (të drejta në fushën e investimeve kapitale, emërimin e drejtorëve të shkollave, etj.);

- Bazuar në ligjin nr. 03/L-068 për arsimin në komunat e Kosovës, autoritetet vendore (Drejtoritë Komunale të Arsimit) ku mësimi zhvillohet në gjuhën serbe, kanë të drejta të pakufizuara edhe në zgjedhje dhe hartimin e planeve dhe programeve mësimore dhe të teksteve dhe mjeteve mësimore apo të përdorimit të njëjtave të përgatitura dhe botuara nga autoritetet arsimore të Republikës së Serbisë, në përputhje me nenin 12 të Ligjit nr. 03/L-068 / 2008;

- Për sa i përket qëllimit dhe parimeve të përgjithshme të dy ligjet, ai i arsimit parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032 përkatësisht fillor në Republikën e Maqedonisë nr.161/2019 dhe 229/2020, janë identike, synojnë dhe mbështesin qëllime, vlera dhe parime të përbashkëta, përmes të cilave sigurohen zhvillimi i gjithanshëm i personalitetit të fëmijës, arritja e një niveli të caktuar të dijeve shkencore mbi botën/natyrën në përgjithësi, zhvillimi i shkathhtësive dhe shprehjeve, zhvillimi i kompetencave të fëmijëve, kultivimi i ndjenjës së atdhedashurisë, bashkëpunimit, mirëkuptimit, tolerancës, vlerësimit të diversitetit kulturor, etnik, racor, gjinor, etj., vijimit të rregullt të arsimit të obligueshëm me ligj - nëntë (9) vjeçar...

- Në Republikën e Kosovës sistemi arsimor i obligueshëm është i organizuar në kohëzgjatje prej 9 vitesh, organizohet përmes një kornize të mësimit tërë jetësor sipas niveleve të ISCED-it si vijon dhe në pajtim me fazat kryesore të Kornizës Kombëtare të Kurrikulës: niveli 0: Arsimi parashkollor

⁴⁶ Po aty, neni 15.

(normalisht mosha zero (0) deri në gjashtë (6) vjeç, faza kyçe 0 dhe një pjesë e fazës 1 e KKK), për moshën pesë (5) deri gjashtë (6) vjeçare (shkollë parafilllore); **Arsimi fillor** që zgjat 5 vite (normalisht prej moshës gjashtë (6) vjeçare, pjesa e mbetur e fazës 1 dhe 2 e KKK); **Arsimi i mesëm i ulët** që zgjat katër (4) vite (normalisht prej moshës dymbëdhjetë (12) vjeçare, faza 3 dhe 4 e KKK); **Arsimi i mesëm i lartë** që zgjat tri (3) vite, varësisht nga kurrikula e përcaktuar nga Ministria (normalisht prej moshës pesëmbëdhjetë (15) vjeçare, faza 5 dhe 6 e KKK), përfshirë gjimnazin, shkollën e mesme profesionale, shkollën e muzikës dhe atë të artit, ndërsa në Republikën e Maqedonisë së Veriut bazuar në nenin 8, pika 1, arsimi fillor është i obligueshëm, zgjat nëntë vite dhe organizohet në tri periudha edukativo-arsimore dhe atë nga klasa e parë deri në klasën e tretë, nga klasa e katërt deri në klasën e gjashtë dhe nga klasa e shtatë deri në klasën e nëntë.

- Përmes dispozitave të caktuara ligjore në të dy shtetet respektuese, është e përcaktuar që prindërit dhe shkolla janë përgjegjës për mosregjistrimin e fëmijëve të tyre në shkollë përkatësisht mosvijimin e rregullt të arsimit fillor të fëmijëve përkatësisht nxënësve dhe atë deri në moshën e përcaktuar me ligj (6-15 vjeçare/klasa e parë e deri në klasën e nëntë).

- Ligji për arsimin fillor në Republikën e Maqedonisë ka një dispozitë; ligjore specifike dhe të përcaktuara më drejtë për sa i përket të drejtës së ofrimit të shërbimeve arsimor për fëmijët/nxënësit të cilët për arsye shëndetësore nuk e kanë mundësinë e vijimit të procesit mësimor në shkollë institucion. Për raste të tilla të mosvijimit të procesit mësimor është përligjur mundësia e ofrimit të shkollimit në shtëpi ose institucion shëndetësor (neni 15)

“**Pika 3** - shkolla organizon proces edukativo-arsimor në kushte shtëpiake si formë e veçantë e punës për nxënësit në mjekim më të gjatë shtëpiak. **Pika 4** - për nxënësit të cilët, për shkak të problemeve shëndetësore ose sëmundjeve kronike, nuk mund të ndjekin mësim më gjatë se tri javë, mësimi organizohet në kushte shtëpiake, përkatësisht në institucion shëndetësor. **Pika 5** - prindi, përkatësisht kujdestari e njofton shkollën për nevojën e mësimin të nxënësit i cili është në mjekim më të gjatë shtëpiak ose spitalor. **Pika 6** - arsimin fillor në institucione shëndetësore dhe ndëshkimore-përmirësuese dhe edukative-përmirësuese, e realizon shkolla e cila është më afër institucionit dhe realizon mësim në gjuhën amtare të nxënësit në këto institucione, **ndërsa në kushte shtëpiake shkolla ku është regjistruar nxënësi**”⁴⁷.

Dispozitat ligjore të lartcekura janë në përputhje të plotë me Deklaratën e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut, përmes të cilave garantohet e drejta për arsim të obligueshëm dhe cilësor, **Konventën mbi të drejtat e fëmijës/1989, neni 28 pika a - shtetet palë njohin të drejtën e fëmijës për arsimim dhe, me qëllim që të arrihet kjo e drejtë, hap pas hapi dhe mbi bazën e mundësive të barabarta, në mënyrë të veçantë ata: (a) bëjnë arsimin fillor të detyrueshëm dhe**

⁴⁷ Ligji nr. 161/2019 dhe 229/2020, neni 15.

falas për të gjithë. Me dispozitat e Kushtetues së Republikës së Maqedonisë, konkretisht neni 15 i Ligjit të arsimit fillor nr.161/2019 dhe 229/2020 garanton dhe siguron respektim të plotë të të drejtave të fëmijëve përkatësisht njeriut për arsim të obligueshëm dhe pa pagesë.

Në Republikën e Kosovës, çështja e mosvijimit të rregullt të procesit edukativ-arsimor të obligueshëm nga nxënësit, për një periudhë të gjatë mësimore, si pasojë e problemeve shëndetësore përkatësisht sëmundjeve kronike nuk është e përligjur në mënyrë specifike, ligji përkatës nr.04/L-032 i mungon një dispozitë e veçantë për trajtimin dhe zgjidhjen meritore të rasteve të kësaj natyre. Ligji në fjalë përmban një dispozitë ligjore (neni 47) por e njëjta nuk e përligj rastin e mungesave të gjata të nxënësve nga procesi mësimor, për arsye shëndetësore përkatësisht të ofrimit të shërbimeve arsimore në shtëpi apo në institucionet shëndetësore.

Në Republikën e Kosovës, MASHT përmes udhëzimit administrativ nr. 6/2022 për vlerësimin e nxënësve në arsimin parauniversitar, është përligjur mënyra e vlerësimit të nxënësve të cilët për arsye shëndetësore, braktisjes së shkollës ose të tjera të arsyeshme mungojnë nga procesi mësimor, më shumë se 1/3 e ditëve të mësimin (neni 11 - provimet e klasës). Në raste të tilla këta fëmijë/nxënës i nënshtrohen provimit të klasës, i cili organizohet në dy afate kohore, në muajin qershor dhe gusht. Kjo dispozitë ligjore nxënësit i cili mungon nga procesi mësimor për një kohë të gjatë për arsye shëndetësore, ia mundëson vetëm kalimin e klasës përmes provimeve të klasës, por nuk i siguron edhe arsim cilësor përkatësisht marrjen e mësimave sikurse nxënësve të tjerë përkatësisht bashkëmoshatarëve të tij/saj.

Në rastet e tilla politikbërësit dhe institucionet edukative-arsimore duke mos u ofruar shërbime arsimore (mësim në kushte shtëpiake ose në institucionin shëndetësor ku trajtohet fëmija) bëjnë shkelje të drejtave themelore të njeriut përkatësisht të fëmijëve, për sa i përket ofrimit të arsimit të obligueshëm. Ofrimi i shërbimeve arsimore të obligueshme nuk duhet kuptuar vetëm pajisja e fëmijës/nxënësit me një dëshmi (certifikatë apo dëftesë) përkundrazi ka të bëjë me ofrimin e një sasive të dijeve dhe kompetencave të tjera, sipas kërkesave/rezultateve minimale të përcaktuara në kurrikulën përkatëse të lëndës përkatësisht fushës kurrikulare.

Conclusions

The research had documented that the human rights of children, namely compulsory education in the Republic of Kosovo, are guaranteed by the Constitution and specific laws, the same are according to the highest international standards, moreover, the non-majority Serb community enjoys additional (higher) rights based on Law no. 03/L-068 (2008, Law on Education in Municipalities of the Republic of Kosovo), including the right to draft and implement their own curricula (Curriculum) different from the rest of system

(institutions managed and monitored by the Kosovo MEST). The constitutions of the two respective countries (Kosovo and North Macedonia) guarantee compulsory, free public education for all, regardless of ethnicity, gender, race, etc., including the education and training of people with different perspectives (difficulties). Even the specific laws on compulsory education in both countries are in line with standards and guarantee compulsory, quality and free public education for all.

The Law on Primary Education in the Republic of North Macedonia No. 161/2019 and 229/2020, unlike the Law No. 04/L-032 on Pre-University Education in the Republic of Kosovo, regulates the provision of compulsory educational services (grades I-IX) for children/students with health problems and chronic diseases in a fair and more advanced manner, offering this community of students quality education and training, even in home and hospital conditions, where the child/student is being treated, respectively, fully fulfills the obligations to respect the fundamental human right to compulsory education according to the Universal Declaration of Human Rights, Article 26, paragraph 1 (1948) respectively the Constitution of North Macedonia (Article 47) and the Law on Primary Education in North Macedonia No. 161/2019 and 229/220.

Recommendations

Amendment and supplementation of Law No. 04/L-032 on pre-university education in Kosovo, specifically through a new article, which justifies the provision of lessons in home conditions and in health institutions for children/students who, due to health issues and chronic illness, are forced to be absent from the learning process for a long period of time.

1. MEST should issue an administrative instruction that would determine in detail the manner and form of organizing learning in home conditions or in health institutions (learning days, teaching schedule, teaching models, preparation of requirements and activities for the child/student, assessment...) institutions responsible for determining the temporary or permanent disability of the child/student to continue the learning process in a regular school, monitoring the learning process and other activities in home conditions or in health institutions where the child/student is being treated.

Recensentë:

Prof. dr. Florent Muçaj

Prof. dr. Florim Salihu

Literatura dhe burimet:

Literatura:

1. Zejnullah Gruda, Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut, Prishtinë, 2010;
2. Wolfgang Benedek (editor), Kuptimi i të drejtave të njeriut (manual), fq.269, Graz, 2009;
3. European Union Agency for Fundamental Rights, Çfarë kuptojmë me të drejtat e njeriut, 2021.

Burimet:

1. Deklarata e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut, 1948;
2. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës (nëntor 1989);
3. Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollat e saj (nëntor 1998);
4. <https://www.humanrights.com/course/lesson/background-of-human-rights/the-background-of-human-rights.html>;
5. https://en.wikipedia.org/wiki/Compulsory_education (parë për herë të fundit më 11.06.2024);
6. OSBE; Qasja e komuniteteve në arsimin parauniversitar, Prishtinë, dhjetor 2018;
7. MASHT, Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës 2021-2024, Prishtinë, 2021;
8. MASHT, Raporti vjetor statistikor me treguesit arsimor 2020/2021, Prishtinë, dhjetor 2021;
9. MASHT, Raporti vjetor statistikor me treguesit arsimor 2022/2023, Prishtinë, dhjetor 2023;
10. Kushtetuta e Kosovës (2008);
11. Kushtetuta e KSAK (1974), Gazeta zyrtare e KSAK nr.4, shkurt 1974;
12. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 08-4642/1 / 17 nëntor 1991;
13. Ligji për Arsimin në Komunitatet e Republikës së Kosovës nr. 03/L-068;
14. Ligji për Arsimin në Komunitatet e Kosovës (2008)
15. Ligji për arsimin fillor në Republikën e Maqedonisë së Veriut, nr.161/2019 dhe 229/2020;
16. MASHT, Udhëzimi administrativ nr. 6/2022, Prishtinë, 2022;